



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRI E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE

**SHPALLJE VENDI VAKANT PËR POZICIONIN:  
SPECIALIST (JURIST)  
DREJTORIA E FINANCËS, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE  
MBËSHTETËSE**

**1. TË DHËNAT PËR POZICIONIN E PUNËS:**

**Emërtesa e pozicionit:** Specialist jurist

**Klasa e pagës:** IV-2

**Spektori:** Spektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

**Drejtoria:** Drejtoria e Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

**Raporton te:** Përgjegjësi i Spektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, si dhe tek Drejtori i Drejtorisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

**2. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT:** Roli i Specialistit jurist të Drejtorisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse përgjigjet te Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, për zbatimin e parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim garantimin normal të kryerjes së proceseve të punës lidhur me çështjet ligjore

**3. DETYRAT KRYESORE:**

- Merr pjesë në grupet e punës gjatë hartimit, rishikimit dhe ndryshimit të akteve ligjore dhe nënligjore;
- Ndjek dhe zbaton procedurat e prokurimeve publike në zbatim të legjislacionit specifik për prokurimin publik;
- Përgatit aktet administrative dhe përpilon kontrata në zbatim dhe funksion të ligjit dhe akteve të brendshme të Agjencisë;
- Përfaqëson institucionin me autorizim/prokurë të Drejtorit Ekzekutiv, në të gjitha shkallët e gjykimit, në procese gjyqësore dhe administrative;
- Përgatit, sipas rastit, propësime, ankime apo rekurse në emër të Agjencisë;
- Bashkëpunon me njësitë e tjera organizative të Agjencisë, në fushën e parandalimit të parregullsive;

#### **4. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDITATI**

**Kushtet e përgjithshme që duhet të plotësojë kandidati janë:**

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f.- Ndaj tij të mos jetë marrë asnjë masë disiplinore gjatë 6 muajve të fundit të periudhës kohore të punës.

#### **5. KËRKESAT E POSAÇME:**

**Arsimi:** Bachelor në shkenca juridike. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi

**Përvoja:** Të ketë paktën 2 (dy) vjet eksperiencë pune.

**Tjetër:** Dije të përgjithshme të parimeve, koncepteve, metodave dhe teknikave të profesionit, të mjaftueshme për të realizuar detyrat e pozicionit. Aftësi për të përzgjedhur informacionin e nevojshëm ose materiale referuese të nevojshme, për të realizuar detyra që lidhen me fushën përkatëse të njohurive; aftësi shumë të mira organizative.

#### **6. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe në përputhje me standardet e legjislacionit shqiptar;
- b - Fotokopje të diplomës. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet në zyrën e protokollit të institucionit me adresë: **Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë** ose në adresën zyrtare të e-mailit: **info@aida.gov.al**.

Kandidatët e interesuar paraqesin kërkesën për aplikim, dokumentacionin si më sipër dhe dokumentacionin vërtetues për kriteret e përgjithshme dhe të posaçme brenda datës: **(11.12.2024 afati i fundit i aplikimit)**.

## **7. REZULTATET PËR FAZËN E KONKURRIMIT**

Në vijim, AIDA do të realizojë:

1- Fazën e parë të konkurrimit e cila konsiston në verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga njëësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore;

*a- nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta në shpalljen për konkurrim.*

*b- nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës;*

2 - Faza e dytë e konkurrimit është faza e intervistimit të punonjësve të kualifikuar nga komisioni.

Në këtë fazë komisioni bën një vlerësim të formimit të përgjithshëm të kandidatëve si dhe vizionit të tyre personal në lidhje me veprimtarinë e AIDA-s.

## **8. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Në përfundim të fazës së dytë komisioni i përzgjedhjes bën një vlerësim me pikë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë.

Për vlerësimin e kandidatëve, secili anëtar jep pikët e tij. Në përfundim pikët e grumbulluara mbledhen. Shuma e pikëve të mbledhura nga të gjithë anëtarët pjesëtohet me numrin e anëtarëve të tij dhe kjo vlerë përbën rezultatin përfundimtar.

Komisioni i Përzgjedhjes jep vlerësimin e tij sipas rregullores mbi kandidatët potencialë për punësim duke e shoqëruar me një raport përmbledhës.

Raporti përmbledhës së bashku me listën e 3(tre) kandidatëve që kanë arritur rezultate më të larta i paraqitet Drejtorit Ekzekutiv brenda një afati 5 (pesë) ditor nga përfundimi i vlerësimit.